

**VENDIM**  
**Nr 14, datë 31.3.2015**

**MBI TARIFAT E UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHOQËRINË "UK ERSEKË" SHA**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, metodologjisë "Për vendosjen e tarifave", si dhe vendimit të KKRR-së nr.22, datë 14.11.2014, "Për miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore për vitin 2015", Komisioni Kombëtar Rregullator

**VENDOSI:**

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë "UK Ersekë" sh.a.:  
Tarifë volumetrike për shërbimet:

|                         | Furnizimi me ujë        | Largimi i ujërave të ndotura |
|-------------------------|-------------------------|------------------------------|
| Konsumator familjar     | 38 lek/m <sup>3</sup>   | 10 lek/ m <sup>3</sup>       |
| Institucione buxhetore: | 100 lek/ m <sup>3</sup> | 13 lek/ m <sup>3</sup>       |
| Ente private            | 110 lek/ m <sup>3</sup> | 18 lek/ m <sup>3</sup>       |

b. Tarifë fikse

|                         | Furnizimi me ujë    |
|-------------------------|---------------------|
| Konsumator familjar     | 100 lek/muaj/klient |
| Institucione buxhetore: | 100 lek/muaj/klient |
| Ente private            | 100 lek/muaj/klient |

2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2015:

- uji pa të ardhura (humbjet) : 55 %
- niveli i matjes: 73 %
- kohëzgjatja e furnizimi 21 orë/ditë
- efica e energjisë -
- efikasiteti i stafit 5.5 p/000/lidhje
- mbulimi me ujë 100 %
- mbulimi me kanalizime 100 %
- norma e arkëtimit 94 %
- cilësia e ujit (klor+koliform) sipas standar-deve.

3. Pagesa rregullatore vjetore për "UK Ersekë" sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave të llogaritura.

4. Vendimi KKRR nr.43, datë 7.1.2013 "Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për sh.a. "UK Ersekë" shfuqizohet.

5. Ky vendim hyn në fuqi më 1.4.2015 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

**KRYETARI**  
**Avni Dervishi**